



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 13451/7970/3614/1198 Regjistri Themeltar

Datë 29.03.2017 regjistrimi

Nr. 216 (86-2021-273) Vendimi

Datë 15.04.2021



V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

KRYESUESE: Altina NASUFI

ANËTAR: Ardian DVORANI

ANËTARE: Blerona HASA

-asistuar nga sekretare gjyqësore *Anjeza Bardulla*, në Tiranë në datë 15.04.2021 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen administrative me palë ndërgjyqëse:

PADITËSE:

Shoqëria “Scholz Internationale Handelsgesellschaft” mbh, përfaqësuar nga avokatët Neritan Kallfa dhe Sajmir Dautaj, pajisur me prokurë të përgjithshme me nr. 1379 rep e nr. 613 kol, datë 14.06.2016.

E PADITUR:

Qendra Kombëtare e Biznesit, përfaqësuar nga znj. Matilda Sinani, pajisur me autorizimin nr. 14093/1 prot., datë 13.11.2019.

PERSON I TRETË:

Gjovana Sokolaj, e bija e Kol dhe Age, lindur më 04.03.1983 në Iballë, Pukë dhe banuese në Lushnjë, Rruga

“Kadri Qystri”, përfaqësuar nga av. Leion Nuraj, pajisur me prokurë të posaçme nr. 1179 rep e nr. 351/1 kol, datë 08.07.2020.

Njoftuar aktet Avokaturës së Shtetit

OBJEKTI:

Shfuqizim i aktit të QKB-së numër prot. 7253/1, datë 22.09.2016;
Shfuqizimi i regjistrimit të aplikimit të kryer nga Gjovana Sokolaj në çështjen me numër CN-885652-08-16;
Kthimin e gjendjes së regjistrimit në gjendjen e mëparshme.

BAZA LIGJORE:

Neni 7, 11/1, 15/a, 17/a e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, nenet 26, 27, 54, 71, 72; Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” neni 90; VKM nr. 864/2015 “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në QKB”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 308 (80-2017-310), datë 06.02.2017 ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.
- Shpenzimet procedurale gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

Kundër këtij vendimi në datë 23.02.2017 ka paraqitur ankim pala paditëse, duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit nr. 308 (80-2017-310), datë 06.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë:



- Gjykata dukshëm ka analizuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, provat dhe faktet e paraqitura nga palët në gjykim, rrethana të cilat e kanë çuar në marrjen e një vendimi të gabuar, për shkaqet e mëposhtme:

Së pari Aplikimi i kryer nga Giovana Sokolaj është në kundërshtim me nenin 26.3 të Ligjit nr. 9723, datë 03.07.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Në rastin në fjalë personi i tretë Gjoana Sokolaj e cila ka nënshkruar formularin e aplikimit në QKB, nuk është përfaqësuese e ligjshme e Scholz Shqipëri sepse nuk është as administratore dhe as ortak e Shoqërisë. Gjithashtu, Gjoana Sokolaj nuk është person i autorizuar për të kryer këtë aplikim pranë QKB dhe depozitimin e dokumenteve shoqëruese.

Gjykata ka gabuar kur ka argumentuar në faqen 3 të Vendimit ku argumenton se (citet):
"Aplikimi me numër çështje CN-885652-08-16, është kryer nga Gjoana Sokolaj, në përputhje me parashikimet e nenit 26 pika 3 të Ligjit Nr.9723, datë 03.07.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre...Pretendimi i paditësit se statuti ka parashikuar si moment të fillimit të efekteve të emërimit të administratorit në regjistrin tregtar, nuk qëndron. Parashikimi i pikës 1 të nenit 95 se statuti mund të parashikohen rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve, nuk i referohet momentit të fillimit të efekteve të emërimit por rregullave të posaçme për emërimin e administratorëve. Pika 1 nuk rregullon vetëm momentin e fillimit të efekteve të emërimit. Kjo pikë parashikon numrin e personave të cilët mund të emërohen administrator, afatin e emërimit, si dhe ripërtëritjen ose jo të këtij afati. Për sa i përket fillimit të efekteve të emërimit të administratorit, ligji e ka parashikuar në mënyrë mjaft të qartë atë. Ky parashikim ka ardhur si nevojë e situatave të ndryshme me të cilat përballlet një shoqëri tregtare. Pikërisht pasi ka raste për të cilat nuk mundet që të lihej në vullnetin e administratorit aktual regjistrimi i aktit të emërimit të administratorit të ri. Pikërisht për këtë arsye është bërë ky ndryshim i kësaj dispozite, duke përcaktuar si moment të fillimit të efekteve të emërimit të administratorit datën e aktit të emërimit të ti.

- Në lidhje me sa më sipër, Gjykata ka bërë një analizë të përciptë të provave dhe fakteve dhe një interpretim akoma më të gabuar të ligjit pasi ajo nuk ka pasur parasysh sa më poshtë vijon:

- *Së pari*: Në bazë të nenit 26.3 të Ligjit nr. 9723 “Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre”. Shoqëria përfaqësohet sipas rregullave që parashikon Ligji nr. 9901/2008 (neni 12) dhe statuti i saj.

Neni 95.1 i Ligjit nr. 9901 përcakton se: “Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në Statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i Administratorëve, i cili hyn në fuqi datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji. *Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve*”.

Në rastin konkret neni 10 (1) Statutit të Shoqërise Scholz Sh.p.k. përcakton ndër të tjera se: “*Emërimi ka pasoja ligjore pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”.

Fjalja e fundit e nenit 95.1 të Ligjit Nr. 9901: “Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve”, është një dispozitë lejuese e cila delegon që statuti i shoqërisë mund të vendosë edhe ndryshe mbi emërimin e administratorëve. Në rastin në fjalë, interpretimi që bën Gjykata (apo më mirë argumentimi i huazuar prej prapësimeve të bëra nga ana e QKB-së) bie në kundërshtim të plotë me frymën dhe germën e ligjit, i cili në rastin në fjalë ka bërë një delegim tek dispozitat statutore për të vendosur rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve. Në qoftë se i referohet fjalisë së 4 të nenit 95.1 të Ligjit Nr. 9901 që përcakton “Emërimi i Administratorëve, i cili hyn në fuqi datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji, leximi që i bën kësaj fjalisë të dispozitës ligjore është tërësisht i gabuar, pasi në rastin konkret është statuti ai që ka përcaktuar rregullin e posaçëm që emërimi ka pasoja ligjore pas regjistrimit në QKB dhe jo më përpara. Pala paditëse theson se personi i tretë, Gjovana Sokolaj, bazuar në argumentimin më sipër, nuk është as administratore e Shoqërisë dhe as person i autorizuar për të kryer veprime në dosjen e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar, nga administratori i ligjshëm i shoqërisë z. Stiehl Frank Manfred, dhe nuk është as administratore e emëruar në përputhje me kërkesat formalo juridike dhe ato materiale të ligjit zbatues. Neni 54/ç i Ligjit 9723/2007 shprehet se QKB verifikon faktin nëse të dhënat e shprehura në aplikim nuk kundërshtojnë në mënyrë të dukshme të dhënat



që përmbajnë dokumentet shoqëruese. Kështu, ritheksohet se e dhëna mbi cilësinë e Gjovana Sokolaj si administratore nuk përputhet me përmbajtjen e dokumentit shoqërues.

- *Së dyti*: Dokumentet shoqëruese të aplikimit nuk janë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe pikërisht sipas përcaktimit të bërë në nenin 90 të Ligjit nr. 9901/2008, kështu nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 27.2 të Ligjit 9723/2007. Gjykata ka gabuar kur ka argumentuar në faqen 4 të vendimit ku argumenton se: “Shqyrtimi i aplikimeve nga nëpunësit e autorizuar, kryhet në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për QKR”, neni 54 dhe brenda kompetencave të njohura nga ky ligj. Për më tepër, në nenin 54/2, përcaktohet se: “QKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi”. Pasi në fakt shkelja e kryer nga ana e të paditurit nuk konsiston në verifikimin e përputhshmërisë së përmbajtjes me kërkesat e ligjit (ashtu siç argumenton në mënyrë të gabuar gjykata) *por me mungesën e verifikimit të kushteve formale për depozitim.*

- Në rastin konkret, dokumentet e paraqitura (Procesverbalit të datës 27.07.2016 të Asamblesë së Ortakëve) i mungojnë tërësisht elementët e formës të përcaktuara nga neni 90 i Ligjit: *I mungon emri i kryetarit dhe i mbajtësit të procesverbalit, rezultati i votimit, mungon lista e pjesëmarrësve, akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme, procesverbali i mbledhjes nuk është nënshkruar nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.*

Në faqen 3 të Aktit nr. Prot. 7253/1, datë 22.09.2016 të nxjerrë nga QKB, kjo e fundit deklaron, ndër të tjera, dhe në kundërshtim me ligjin, se nuk është kompetente të shqyrtojë nëse janë zbatuar formalitetet në nxjerrjen e akteve të shoqërive tregtare. Ndërkohë, neni 27, paragrafi 2 i Ligjit 9723/2007 përcakton shprehimisht se: “Dokumentet shoqëruese duhet të jenë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara në legjislacionin përkatës ose në dispozitat e këtij ligji”. QKB sipas nenit 54 të Ligjit 9723/2007 verifikon pikërisht plotësimin e dokumenteve shoqëruese dhe paraqitjen e tyre në formën e duhur. Pra, duke ju referuar asaj ç’ka neni 90 i Ligjit 9901/2008 përcakton, rezulton se vërtet nuk shprehet për detyrimin e subjektit për depozitim në QKR të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë, por, përveçse ky detyrim buron rrjedhimisht dhe natyrshëm nga detyrimi i subjektit tregtar për të paraqitur në QKB dokumentacionin shoqërues (pjesë e të cilit është edhe procesverbali), në këtë rast personi i tretë Gjovana Sokolaj ka paraqitur në QKB

pikërisht “Procesverbalin e Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme të Scholz sh.p.k.”. Detyrimi për depozitimin e procesverbalit të asamblesë në QKB përforcohet edhe nga neni 1, paragrafi 5 i Ligjit 9901/2008, Në këtë formë, detyrimi që përcakton neni 90 i Ligjit 9901/2008 lidhur me publikimin nga administratori i shoqërisë të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë është drejtpërdrejt i lidhur me publikimin e procesverbalit në QKB, veprim i cili (publikimi) në rastin konkret është kryer nga QKB duke depozituar në Regjistrin Tregtar dokumentin e paraqitur nga Gjovana Sokolaj, pa e gëzuar cilësinë e administratorit të shoqërisë, “Procesverbalin e Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme të Schols sh.p.k”, datë 27.06.2016. Edhe për këtë arsye, QKB detyrimisht duhej të verifikonte elementët e këtij procesverbali, për të konstatuar lehtësisht se dokumenti shoqërues nuk plotëson kërkesat formale të nenit 27 të Ligjit 9723/2007. Në seancën e datës 01 shkurt 2017 pala e tretë Gjovana Sokolaj, me argumentimin se po provonte aktin e thirrjes së Asamblesë paraqiti një mandat postar. Ky mandat në fakt nuk provon aspak pretendimet e palës së tretë në proces, pasi i mungon çdo element lidhës midis këtij mandati postar dhe njoftimit të thirrjes së mbledhjes së asamblesë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, me vendimin e datës 23.02.2017 ka vendosur pranimin e ankimit.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Në seancë gjyqësore, pasi dëgjoji palët që pretenduan:

Pala paditëse/ankuese: Ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë dhe pranimin e padisë.

Përfaqësuesja e palës së paditur Qendra Kombëtare e Biznesit: lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë.

Përfaqësuesin e personit të tretë Gjovana Sokolaj që kërkoi: lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë dhe ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore dhe avokatore palës paditëse.

Si analizoi çështjen në raport me shkaqet e parashtruara në ankim,

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes:

1. Pala paditëse, Shoqëria Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH, është shoqëri e së drejtës gjermane, ortak i Shoqërisë Scholz shpk, një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar në regjistrin tregtar më datë 25.04.2008, me NIPT K86625002F, e cila operon në tregun shqiptar të grumbullimit, përpunimit, riciklimit, tranzitimit, transportimit dhe eksportimit të mbetjeve të ngurta dhe të vëllimshme me përmbajtje metalore. Subjekti “Scholz Shpk”, rezulton i regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS K86625002F, me ortak Gjovana Sokolaj zotërues 25%, Doni Sokolaj zotërues 25% dhe “Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH” zotërues 50%, me status aktiv.

1.1 Pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (në tekstin vijues QKB), më datë 18.08.2016 është miratuar aplikimi me numër çështje CN-885652 08-16, ku është depozituar procesverbali i mbledhjes së dytë të përgjithshme të “Scholz” sh.p.k datë 27.07.2016 të asamblesë së ortakëve, ku është vendosur:

1- Ndryshimi i adresës së regjistruar të shoqërisë.

2- Emërimi i administratorit të dytë të kompanisë Znj. Gjovana Sokolaj.

Në aplikimin me numër çështje CN-885652-08-16, janë paraqitur këto dokumente:

Formulari i aplikimit datë 17.08.2016;

Procesverbali i mbledhjes së dytë të përgjithshme të “Scholz” datë 27.07.2016;

Dokumenti i identifikimit të aplikantit;

Mandat arkëtimi për aplikim, datë 17.08.2016.

1.2 Në datën 19.09.2016 paditësi ka paraqitur ankim administrativ duke kërkuar shfuqizimin e regjistrimit më numër çështje CN-885652-08-16 dhe kthimin e gjendjes së regjistrimit në gjendjen e mëparshme. Pala e paditur, QKB, me shkresën numër prot. 7253/1 date 22.09.2016, për të cilin paditësi ka marrë dijëni më datë 30 shtator 2016, nuk ka marrë në konsideratë ankimin e paraqitur nga paditësi, me argumentin ndër të tjera se... *nuk është kompetente të shqyrtojë nëse janë zbatuar formalitetet në nxjerrjen e akteve të shoqërive tregtare..*



2. Pala paditëse duke mos qenë dakord me regjistrimin në QKR, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi në datë 21.10.2016 me këto pretendime:

2.1 Personi i tretë Gjovana Sokolaj e cila ka nënshkruar formularin e aplikimit në QKB, nuk është përfaqësuese e ligjshme e Shoqërisë “Scholz” në Shqipëri sepse nuk është as administratore dhe as ortakë e Shoqërisë. Gjithashtu, Gjovana Sokolaj nuk është person i autorizuar për të kryer këtë aplikim pranë QKB dhe depozitim të dokumenteve shoqëruese. Edhe pse është lehtësisht e provueshme se Asambleja e mbajtur është e pavlefshme pasi nuk është thirrur rregullisht nga Administratori i Shoqërisë, Z. Frank Manfred Stiehl, nga pikëpamja formale, sipas nenit 54/b të ligjit 9723/2007 dhe paragrafit 19 të VKM 864/2015, QKB detyrohet të kryejë verifikimin me hollësi të plotë të të gjitha të dhënave të detyrueshme si dhe dokumentet shoqëruese. Neni 2, pika 7 dhe 9, i Ligjit 9723/2007 përkufizon: *“Të dhënat” si fakte, akte dhe informacione që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në Regjistër, “Dokumentet shoqëruese” si dokumentet të cilat provojnë të dhënat që regjistrohen*”. Në zbatim të këtij detyrimi, dhe duke qenë se në procesverbalin datë 27.07.2016 parashikohet si fakt dhe/ose informacion se janë kryer nga administratori dy njoftime të mbajtjes së Asamblesë, QKB duhej të verifikonte dhe konstatonte në dokumentin shoqërues se këto thirrje nuk janë kryer nga administratori i Shoqërisë Z. Frank Manfred Stiehl, por nga Gjovana Sokolaj. Rrjedhimisht, ka një mospërputhje midis të dhënave dhe dokumenteve shoqëruese. Fjalja e fundit e nenit 95.1 të ligjit Nr. 9901: *“Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve”, është një dispozitë lejuese e cila delegon që statuti i shoqërisë mund të vendosë edhe ndryshe mbi emërimin e administratorëve*. Procesverbali i datës 27.07.2016 është mbajtur në një asamble e cila nuk është thirrur rregullisht nga administratori sipas kërkesave të pjesës hyrëse të Statutit të Shoqërisë dhe nenit 13 të tij: *“Asambleja thirret nga Administratori, nëpërmjet një njoftimi me shkrim dhe i drejtohet secilit prej ortakëve sipas parashikimeve në këtë Statut në lidhje me komunikimet në Shoqëri: Të gjitha komunikimet do të konsiderohen të kryera rregullisht kur u dërgohen ortakëve në adresat që i janë komunikuar administratorëve*”. Si rrjedhim, Asambleja nuk mund të merrte vendime të vlefshme, referuar nenit 83 të ligjit 9901/2008. Dokumentet shoqëruese të aplikimit nuk janë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe pikërisht sipas përcaktimit të bërë në nenin 90 të ligjit nr. 9901/2008, kështu nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 27.2 të ligjit 9723/2007. Në rastin konkret, dokumentet e paraqitura (Procesverbali datë 27.07.2016 i

Asamblesë së Ortakëve) i mungojnë tërësisht elementet e formës të përcaktuara nga neni 90 i ligjit: mungon emri i kryetarit dhe i mbajtësit të procesverbalit, rezultati i votimit, mungon lista e pjesëmarrësve, akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme, procesverbali i mbledhjes nuk është nënshkruar nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Detyrimi për depozitim të procesverbalit të asamblesë në QKB përforcohet edhe nga neni 1, paragrafi 5 i ligjit 9901/2008, i cili parashikon: "Dispozitat, që kërkojnë dhënie informacioni në faqen e shoqërisë në internet, mund të zbatohen nëpërmjet krijimit të një lidhjeje informatike të drejtpërdrejtë me faqen në internet, ku Qendra Kombëtare e Regjistrimit publikon informacionin për tregtarin apo shoqërinë përkatëse". Në këtë formë, detyrimi që përcakton neni 90 i ligjit 9901/2008 lidhur me publikimin nga administratori i shoqërisë të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë është drejtpërdrejt i lidhur me publikimin e procesverbalit në QKB, veprim i cili (publikimi) në rastin konkret është kryer nga QKB duke depozituar në Regjistrin Tregtar dokumentin e paraqitur nga Gjovana Sokolaj, pa e gëzuar cilësinë e administratorit të shoqërisë, "Procesverbalin e Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme të Scholz Sh.p.k." datë 27.06.2016. Edhe për këtë arsye, QKB detyrimisht duhej të verifikonte elementet e këtij procesverbali, për të konstatuar lehtësisht se dokumenti shoqërues nuk plotëson kërkesat formale të nenit 27 të ligjit 9723/2007. Regjistrimi i kryer dhe Akti i QKB-së bie gjithashtu në kundërshtim me një sërë parimesh të Kodit të Procedurave Administrative, që QKB, si organ publik në veprimtarinë e tij duhet të respektojë, me parimin e ligjshmërisë (neni 4 i ligjit 44/2015), të drejtësisë dhe të paanshmërisë (Neni 13 i ligjit 44/2015), të objektivitetit (Neni 14 i ligjit 44/2105), të marrjes së vendimeve (Neni 16 i ligjit Nr. 44/2015) dhe në kushtet kur shkelja e kryer prej saj është kaq e evidente dhe flagrante në dëm të interesave të paditësit, QKB nuk duhet të kishte kryer regjistrimin e goditur me këtë kërkesë padi.

3. Pala e paditur dhe personi i tretë, (kanë të njëjtin qëndrim) kanë prapësuar se paditësi, ortaku i shoqërisë "Scholz" sh.p.k në kërkesëpadinë e tij nuk ka argumentuar se cila është e drejta apo interesi i tij i ligjshëm i cenuar nga veprimi i QKB për regjistrimin e ndryshimeve të sipërcituara. Ndryshimet në regjistrin në çështjen me numër CN-885652-08-16 janë kryer mbi bazën e akteve të shoqërisë të paraqitura në këtë aplikimin. Në rast se, paditësi është cenuar në të drejtat e tij që rrjedhin nga zotërimi i kuotës në shoqërinë tregtare "Scholz" sh.p.k, atëherë ai këto pretendime nuk mund t'i ngrejë kundër QKB, por ndaj shoqërisë ortak në të cilin është apo ndaj organeve të

saj, duke kundërshtuar vendimmarrjen. Aplikimi me numër çështje CN-885652-08-16, është kryer nga Gjovana Sokolaj, në përputhje me parashikimet e nenit 26, pika 3, të ligjit nr. 9723, datë 03.07.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Për sa i përket fillimit të efekteve të emërimit të administratorit, ligji e ka parashikuar në mënyrë mjaft të qartë atë. Ky parashikim ka ardhur si nevojë e situatave të ndryshme me të cilat përballet një shoqëri tregtare. Pikërisht pasi ka raste për të cilat nuk mundet që të lihej në vullnetin e administratorit aktual regjistrimi i aktit të emërimit të administratorit të ri. Pretendimi i paditësit se: “Është lehtësisht e provueshme se asambleja e mbajtur është e pavlefshme pasi nuk është thirrur nga administratori”, pra për pavlefshmërinë e mbledhjes së asamblesë së datës 27.07.2016, nuk mund t’i kundrejtohet QKB në një proces administrativ.

II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

4. Gjykata ka rrëzuar padinë me këtë arsytim:

4.1 *Së pari*: Kërkesëpadia objekt gjykimi është ngritur nga shoqëria “Scholz International Handelsellschaft” mbH, në cilësinë e ortakut të shoqërisë “Scholz”sh.p.k. Me anë të kësaj kërkesë padie kërkohet shfuqizimi i regjistrimit CN-885652-08-16, në të cilën janë regjistruar ndryshime në të dhënat e shoqërisë lidhur me selinë e shoqërisë “Scholz” SH.P.K dhe emërimin e administratorit të dytë të saj. Bazuar në nenin 15 të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të drejtën e ngritjes së padisë e ka çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik. Duke u bazuar në nenin 71 të ligjit nr. 9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj veprimeve/mosveprimeve të QKB për regjistrimet dhe publikimet e kryera. Ndërkohë, neni 72, paragrafi 3 i këtij ligji parashikon të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj aktit të titullarit të QKB, edhe duke u drejtuar drejtpërdrejt në gjykatë (pa ezauruar më parë procedurën e ankimit administrativ), sipas legjislacionit që rregullon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative. Referuar VKM nr. 864/2015, pika 20, personat të cilët hartojnë aktin sipas dispozitave ligjore në fuqi mbajnë përgjegjësi për saktësinë e të dhënave të deklaruara. Në rastin konkret, ortaku i vetëm i Scholz Shqipëri, i cili është personi që sipas ligjit harton aktin

vendim, është përgjegjës për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të cilat janë deklaruar me vendimin e depozituar nga QKB (ref. CN objekt ankimi gjyqësor) në dosjen e Scholz Shqipëri në regjistrin tregtar. Padiësi bazohet në nenin 12 (4) dhe 101 (1) të Ligjit nr. 9901/2008 “Për Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare” duke evidentuar në funksion të legjitimitetit aktiv në këtë gjykim argumentin se sipas këtyre dispozitave administratorët kryejnë veprimet të cilat ndikojnë në mënyrë direkte interesat e ortakut të shoqërisë, kapitalin e zotëruar prej tij në shoqëri dhe fitimin që shpërndahet. Në rast se, padiësi është cenuar në të drejtat e tij që rrjedhin nga zotërimi i kuotës në shoqërinë tregtare “Scholz” Sh.p.k, atëherë ai këto pretendime nuk mund t'i ngrejë kundër QKB, por ndaj shoqërisë ortak në të cilin është apo ndaj organeve të saj, duke kundërshtuar vendimmarrjen e këtyre organeve në një proces civil-tregtar, bazuar në nenet 88 e 93 të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

4.2 *Së dyti*: Pretendimi i padiësit se: “Gjovana Sokolaj e cila ka nënshkruar formularin e aplikimit në QKB, ka aplikuar në emër dhe për llogari të shoqërisë. Gjovana Sokolaj nuk përfaqëson shoqërinë sepse nuk është administratore dhe as ortake e shoqërisë. Gjithashtu, Gjovana Sokolaj nuk është person i autorizuar për të kryer këtë aplikim pranë QKB dhe depozitimin e dokumenteve shoqëruese”, nuk qëndron. Sipas të dhënave të regjistrin tregtar, pasqyruar edhe në ekstraktin për të dhënat e regjistruara të shoqërisë “Scholz” Sh.p.k, Gjovana Sokolaj, figuron ortake e shoqërisë, zotëruese e 25 % të kuotave. Me aktin “Procesverbal i mbledhjes së dytë të përgjithshme të “Scholz” datë 27.07.2016, Gjovana Sokolaj, ka fituar cilësinë e administratorit të shoqërisë. Në pikën 1 të nenit 95 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, parashikohet se: *1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundërdrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.*

Dispozita e sipërcituar, e cila është në fuqi me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime” në Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ka përcaktuar se, *emërimi i administratorëve hyn në fuqi në datën e përcaktuar në aktin e emërimit.* Në procesverbalin e mbledhjes së dytë të përgjithshme të “Scholz” datë 27.07.2016, ndër të tjera është vendosur: “Emërimi dhe aprovimi si një administrator i dytë i

kompanisë znj.Gjovana Sokolaj...”. Aplikimi me numër çështje CN-885652-08-16, është kryer nga Gjovana Sokolaj, në përputhje me parashikimet e nenit 26, pika 3, të Ligjit Nr. 9723, datë 03.07.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Pretendimi i paditësit se statuti ka parashikuar si moment të fillimit të efekteve të emërimit të administratorit regjistrimin në regjistrin tregtar, nuk qëndron. Parashikimi i pikës 1 të nenit 95 se statuti mund të parashikojë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve, nuk i referohet momentit të fillimit të efekteve të emërimit por rregullave të posaçme për emërimin. Pika 1 nuk rregullon vetëm momentin e fillimit të efekteve të emërimit. Kjo pikë parashikon numrin e personave të cilët mund të emërohen administrator, afatin e emërimit, si dhe ripërtëritjen ose jo të këtij afati. Për sa i përket fillimit të efekteve të emërimit të administratorit, ligji e ka parashikuar në mënyrë mjaft të qartë atë. Ky parashikim ka ardhur si nevojë e situatave të ndryshme me të cilat përballet një shoqëri tregtare. Pikërisht pasi ka raste për të cilat nuk mundet që të lihej në vullnetin e administratorit aktual regjistrimi i aktit të emërimit të administratorit të ri. Pikërisht për këtë arsye është bere ky ndryshim i kësaj dispozite, duke përcaktuar si moment të fillimit të efekteve të emërimit të administratorit datën e aktit të emërimit të tij.

4.3 *Së treti:* Pretendimi i paditësit për pavlefshmërinë e mbledhjes së asamblesë së datës 27.07.2016, nuk mund t'i kundërdrejtohet QKB në një proces administrativ, por shoqërisë/asamblesë së ortakëve në një proces civil tregtar. Shqyrtimi i aplikimeve nga nëpunësit e autorizuar, kryhet në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për QKR”, neni 54 dhe brenda kompetencave të njohura nga ky ligj. Për me tepër, në nenin 54/2, përcaktohet se: “*QKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi*”. Sjellim në vëmendje se, kalimi i regjistrit tregtar, nga gjykata, në të cilën regjistrimi në regjistër i akteve nga subjektet kalonte në një proces gjyqësor, në administrimin e këtij regjistri nga një organ administrativ, një proces administrativ, realizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, ligji mbi bazën e të cilit u krijua dhe operon QKR (aktualisht QKB), kishte si qëllim pikërisht “*lehtësimin e regjistrimit të biznesit në Shqipëri dhe sigurimin e aksesit publik në të dhënat e regjistruara*”. Në këtë kuadër, dhe referuar dispozitave

ligjore, QKB nuk është krijuar për të kryer proces hetimor lidhur me procedurat, afatet apo përmbushjen e kërkesave ligjore midis ortakëve/aksionarëve apo organeve drejtuese të subjekteve tregtare në marrjen e akteve nga ana e këtyre subjekteve. Janë këto të fundit, që kanë detyrimin të zbatojnë dhe respektojnë kuadrin ligjor, mbi bazën e të cilit mbështetet organizimi dhe funksionimi i shoqërive tregtare. Në këtë kuadër, subjektet e interesuar të cilët pretendojnë se janë cenuar apo i janë shkelur të drejtat nga vendimet apo aktet e organeve të shoqërisë duhet që këto pretendime t'ia kundërdrejtojnë organeve të shoqërisë dhe jo QKB. QKB-ja, pasi kryen verifikimet përkatëse, sipas nenit 54 të këtij ligji dhe vëren përmbushjen e kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin në regjistër. Bazuar në nenin 55, pika 2 të ligjit të sipërcituar, QKB nuk mund të refuzojë regjistrimin, nëse aplikimi është dorëzuar sipas parashikimeve të këtij ligji. Nga ana tjetër është detyrim i organeve drejtuese të shoqërisë, zbatimi dhe respektimi i dispozitave ligjore në fuqi dhe statutit të shoqërisë. Në çdo rast, detyrimi dhe garantimi i vijueshmërisë së marrëdhënieve juridike midis ortakëve nuk është objekt vlerësimi dhe shqyrtimi nga QKB. Në rastin e depozitimit të akteve të shoqërisë në regjistrin tregtar, QKB, kryen veprimet përkatëse, që lidhen me regjistrimet e nevojshme mbi ndryshimet në personin juridik. QKR, shikon vetëm anën formale të akteve të paraqitura dhe nuk analizon përmbajtjen e tyre lidhur me vlefshmërinë apo pavlefshmërinë, apo respektimin e dispozitave ligjore, mbi bazën e të cilave organizohen dhe funksionojnë subjektet tregtare, sikurse pretendohet nga paditësi referuar nenit 90 të ligjit 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Për sa më sipër, gjykata çmon se kërkesëpadia e palës paditëse nuk gjendet e bazuar në ligj dhe në prova për pasojë duhet të rrëzohet.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

5. Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, sikurse ka vlerësuar drejt edhe gjykata administrative e shkallës së parë, Gjykata e Apelit konstaton se ankimi i palës paditëse është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 49/2012 *Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*, i ndryshuar brenda afatit ligjor 15 ditor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i Kodit të Procedurës Civile, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar aktivisht në padi, legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 (*vendimet e paankimueshme*). Nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi, Gjykata Administrative e Apelit çmoi se debati gjyqësor është i nevojshëm me qëllim të konstatimit të drejtë të rrethanave faktike

të çështjes sipas përcaktimeve të nenit 51/1 të ligjit nr. 49/2012 dhe për këtë arsye vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

6. Në gjykimin në seancë gjyqësore, Gjykata Administrative e Apelit sipas nenit 1, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, në lidhje me nenin 465 të Kodit të Procedurës Civile, riçeli pjesërisht hetimin gjyqësor duke u administruar provat e reja të paraqitura nga palët: Vërtetim i Gjykatës së Apelit Tiranë datë 18.02.2020; Apelim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendim Penal nr. 1994, datë 03.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 26.11.2017; Vërtetim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 16.01.2017; Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. 3195 viti 2016 datë 26.04.2017; Procesverbal Marrje Provash datë 14.06.2016; Procesverbal për kallëzimin e krimit datë 14.06.2016; Kallëzim për ndjekje penale datë 27.01.2016; vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 5376, datë 27.10.2015 lënë në fuqi me vendimi nr. 1389, datë 26.05.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; Vendim për ndreqje gabimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë datë 25.11.2015; Vendim i Gjykatës së Apelit Administrativ nr. 3648, datë 17.1.2018; Ekstrakt QKB i shoqërisë paditëse.

7. Referuar shkaqeve të ngritura në ankimin e palës paditëse në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, Gjykata Administrative e Apelit vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 308, datë 06.02.2017, është rrjedhojë e cilësimit jo të drejtë ligjor të mosmarrëveshjes në gjykim në raport me kërkimet e padisë, shkakun ligjor të saj dhe provat e në pasojë ka vend për t’u ndryshuar duke u pranuar padia, për këto arsye:

8. Në shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të palës së paditur në raport me pretendimet e ngritura në ankim, Gjykata Administrative e Apelit i referohet parimit procedural të gjyimit administrativ të sanksionuar në neni 37, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, parim sipas të cilit gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim Gjykata Administrative e Apelit

gjithashtu i referohet parimit tjetër procedural të gjykimit administrativ të sanksionuar në nenin 17, pika 2 të ligjit të sipërcituar sipas të cilit gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo i bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson se cilësimi i fakteve objekt mosmarrëveshje nga ana e gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e një vlerësimi të veprimtarisë së anës së paditur të kryer jo në përputhje me parashikimet e ligjit që normon veprimtarinë e Qendrës Kombëtare të Biznesit, ligjin nr. 9723 datë 03.05.20007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar. Në përgjigje pretendimeve të parashtruara në ankim, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson të evidentojë kuadrin ligjor të zbatueshëm në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes në gjykim. Në ligjin nr. 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, rregullohen përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe disiplinohen kërkesat që duhet të plotësojë një aplikim për regjistrim.

8.1 Kështu në nenin 26 të këtij ligji me titull “Personat e autorizuar për të bërë regjistrimin” parashikohet se:

1. Aplikimi për regjistrim fillestar dhe regjistrimet e tjera të personave fizikë bëhet nga vetë personi që regjistrohet apo nga çdo person i autorizuar prej tij.
2. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta bëhet nga të gjithë anëtarët apo nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.
3. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit apo nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortaku apo aksioneri, të cilit këto i përkasin.
4. Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja bëhet nga përfaqësuesi ligjor i degës apo zyrës së përfaqësimit, nga

përfaqësuesi ligjor i shoqërisë së huaj apo nga çdo person i autorizuar nga njëri prej personave të përmendur më sipër.

5. Aplikimi për regjistrimin fillestar e regjistrimet e tjera të shoqërive dhe unioneve të kursimkredive bëhet nga kryetari i bordit drejtues apo nga çdo person i autorizuar prej tij.

6. Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të shoqërive të ndihmës e bashkëpunimit të ndërsjellë bëhet nga kryetari i këshillit administrativ ose nga çdo person i autorizuar prej tij. (Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

7. Për subjektet e tjera që kanë detyrimin e regjistrimit, sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 22, të këtij ligji, aplikimi për regjistrim fillestar bëhet nga personat e përcaktuar, në përputhje me ligjet përkatëse, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. (Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

8. Janë të autorizuar të aplikojnë për regjistrim personat e tjerë, që u njihet kjo e drejtë me ligj të veçantë.

Neni 27 “Aplikimi dhe forma e dokumenteve shoqëruese” i ligjit të sipërcituar përcakton se:

1. Regjistrimi kryhet me dorëzimin e aplikimit përkatës, të cilit i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen.

2. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të panjësuar me origjinalin dhe të jenë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji. Dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen edhe në format elektronik, sipas parashikimeve të kreut VI. Dorëzimi i dokumentit shoqërues pranë sporteleve të shërbimit në kopje të panjësuar apo në format elektronik bëhet nën përgjegjësinë e plotë të personit që e paraqet atë, i cili, nëpërmjet aktit të dorëzimit, konfirmon njësinë e kopjes apo të dokumentit në format elektronik me origjinalin. (Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

3. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në

gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

4. Në rast mos përputhjeje të dokumentit shoqërues në gjuhën shqipe me atë në gjuhë të huaj, ky i fundit nuk mund t'u kundrejtohet palëve të treta. Gjithsesi, palët e treta mund t'i kundrejtojnë subjektit të dhënave të përmbajtura në dokumentin në gjuhë të huaj, përveç rastit kur subjekti provon se i treti kishte dijeni për përmbajtjen e dokumentit në gjuhën shqipe.

Kurse po në këtë ligj, neni 54 të tij 'Shqyrtimi i aplikimit' përcakton se:

1. QKR-ja asiston aplikantin në plotësimin e aplikimit dhe verifikon:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;
b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;
c) paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënave që regjistrohen;

c) faktin nëse të dhënave të shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënave që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë formularin;

d) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik; dh) nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet;

e) pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim;

ë) faktin nëse aplikuesi ka shlyer sanksionet administrative të dhënave dhe ka kryer regjistrimet e kërkuara sipas nenit 46. (Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.).

2. QKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi. (Ndryshuar me Ligj, Nr.8/2015, dt. 19.02.2015, botuar në FLZ. Nr.32, datë 9 mars 2015.)

3. QKR-ja lëshon një konfirmim me shkrim, sipas një formati të miratuar, për çdo aplikim të dorëzuar.

4. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë kohën e dorëzimit, numrin rendor të paraqitjes së aplikimit, objektin e aplikimit, listën e dokumenteve të dorëzuara dhe shumën e tarifës së paguar.

5. QKR-ja merr në shqyrtim aplikimet për regjistrim, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

6. QKR-ja është e detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse aplikimi është i paplotë, apo dokumentet shoqëruese të pasakta. Në çdo rast QKR-ja përgjigjet me shkrim.

Neni 55 i po këtij ligji ka parashikuar se:

1. QKR-ja, pasi kryen verifikimet përkatëse, sipas nenit 54 të këtij ligji dhe vëren përmbushjen e kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin në regjistër dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda një afati prej një dite nga data e paraqitjes së aplikimit.
2. QKR-ja nuk mund të refuzojë regjistrimin, nëse aplikimi është dorëzuar sipas parashikimeve të këtij ligji

Në bazë e për zbatim të këtij ligji ka dalë edhe akti nënligjor VKM nr. 864, datë 21.05.2015 “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në qendrën kombëtare të regjistrimit”, 5. Aplikimi për regjistrim bëhet nga personat e autorizuar, sipas përcaktimit të nenit 26 të ligjit, duke deklaruar të dhënat nëpërmjet paraqitjes së aplikimit përkatës, të plotësuar me të gjitha fushat e detyrueshme, si dhe duke paraqitur dokumentet shoqëruese, të kërkuara për llojin e regjistrimit që kërkohet të kryhet.

...

19. Nëpunësi i autorizuar i QKR-së (regjistruesi) verifikon me hollësi nëse aplikimi dhe dokumentet shoqëruese janë në përputhje me kërkesat e pikës 1, të nenit 54, të ligjit, si dhe verifikon veprimet e kryera nga nëpunësi i sportelit.

20. Kur nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) vëren se aplikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit, vlerëson vetëm plotësimin e kërkesave të përcaktuara në pikën 1, të nenit 54, të ligjit. Në këtë vlerësim nëpunësi i autorizuar nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave, vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave të deklaruara ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit, mbahet nga personat që kanë bërë deklaramet ose që kanë hartuar aktin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Gjykata Administrative e Apelit i referohet për zbatim edhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar në nenin 12 ‘Përfaqësuesit ligjorë’ të tij përcakton se:

1. Shoqëritë tregtare përfaqësohen sipas rregullave të përcaktuara nga ky ligj dhe dispozitave të statutit. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.

2. Përfaqësuesit ligjorë zbatojnë të gjitha kufizimet e tagrave të përfaqësimit, të përcaktuara në statut apo të miratuara nga organet përkatëse të shoqërisë. Me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për kufizimin, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të, kufizimi i kompetencave nuk mund t'i kundrejtohet palëve të treta, edhe nëse këto kufizime janë bërë publike në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Publikimi i kufizimit nëpërmjet publikimit të vendimeve të organit përkatës të shoqërisë apo statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky kufizim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3. Veprimet e kryera nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Çdo parregullsi në emërimin e përfaqësuesit ligjor nuk përjashton apo kufizon përgjegjësinë e shoqërisë ndaj palëve të treta, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për parregullsinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 90 i po këtij ligji i titulluar 'Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë' përcakton se:

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.



Kurse në nenin 95 të tij 'Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet' i ligjit të sipërcituar përcakton se:

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207¹ të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

¹ Neni 207 "Mëma dhe shoqëritë e kontrolluara"

1. Vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, kur një shoqëri tregtare sillet e vepron rregullisht, sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër. Ky kontroll quhet grup kontrollues. 2. Kur një shoqëri, në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, atëherë kjo shoqëri vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, ndërsa shoqëria tjetër vlerësohet shoqëri e kontrolluar. Ky kontroll quhet grup influencues. 3. Të drejtat e mëmës mbi shoqërinë e kontrolluar, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, vlerësohen të tilla edhe në rastin kur këto të drejta ushtrohen nëpërmjet një shoqërie tjetër, të kontrolluar nga mëma apo nga një person i tretë, që vepron për llogari të kësaj shoqërie tjetër apo për llogari të vetë shoqërisë mëmë. I treti prezumohet se vepron për llogari të shoqërisë mëmë, nëse ai përfshihet në përcaktimet e pikave 2 e 3 të nenit 13 të këtij ligji.

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

Ky ligj është ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar i cili në nenin 15 të tij përcakton se: Në nenin 95 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë: “Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji.”.

9. Zhvillimi i gjykimit në shkallë të parë ka vërtetuar se më datë 18.08.2016 është miratuar aplikimi me numër çështje CN-885652 08-16, ku është depozituar procesverbali i mbledhjes së dytë të përgjithshme të “Scholz” sh.p.k datë 27.07.2016, të asamblesë së ortakëve, ku është vendosur:

1- Ndryshimi i adresës së regjistruar të shoqërisë.

2- Emërimi i administratorit të dytë të kompanisë Znj. Gjovana Sokolaj.

Në aplikimin me numër çështje CN-885652-08-16, janë paraqitur këto dokumente:

Formulari i aplikimit datë 17.08.2016;

Procesverbali i mbledhjes së dytë të përgjithshme të “Scholz” datë 27.07.2016;

Dokumenti i identifikimit të aplikantit;

Mandat arkëtimi për aplikim, datë 17.08.2016.

Në datën 19.09.2016 paditësi ka paraqitur ankim administrativ duke kërkuar shfuqizimin e regjistrimit me numër çështje CN-885652-08-16 dhe kthimin e gjendjes së regjistrimit në gjendjen e mëparshme. Pala e paditur, QKB, me shkresën numër prot. 7253/1 datë 22.09.2016, për të cilin

paditësi ka marrë dijeni më datë 30 Shtator 2016, nuk ka marrë në konsideratë ankimin e paraqitur nga paditësi.

10. Në një vlerësim të ndryshëm të fakteve dhe provave në raport me zbatimin e kuadrit ligjor të lartëcituar, ndryshe nga argumentimi i gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se referuar parashikimeve të nenit 54 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 i ndryshuar, ku përcaktohet ndër të tjera se *QKB-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi*, rezulton se nëpunësi i palës së paditur vërtet nuk mund të kryejë verifikime lidhur me procedurat, afatet apo përmbushjen e kërkesave ligjore apo statutore midis ortakëve, aksionerëve apo organeve drejtuese të subjekteve tregtare në nxjerrjen e akteve prej tyre, por pala e paditur QKB ka detyrimin ligjor të verifikojë faktin nëse të dhënat e shprehura në aplikim nuk kundërshtojnë në mënyrë të dukshme të dhënat që përmbajnë dokumentet shoqëruese të aplikimit. Referuar pikërisht aktin nënligjor që ka dalë në bazë e për zbatim të ligjit të sipërcituar e konkretisht VKM nr. 864, datë 21.05.2015 “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në qendrën kombëtare të regjistrimit”, në pikën 19 të tij citohet qartësisht se: *Nëpunësi i autorizuar i QKR-së (regjistruesi) verifikon me hollësi nëse aplikimi dhe dokumentet shoqëruese janë në përputhje me kërkesat e pikës 1, të nenit 54, të ligjit, si dhe verifikon veprimet e kryera nga nëpunësi i sportelit*. Ky detyrim përforcohet më tej referuar përmbajtjes së nenit 27 pika 2 të ligjit nr. 9723/2008 i ndryshuar, që përcakton se dokumentet shoqëruese.....*duhet të jenë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji ...në rastin konkret dokumentet e paraqitura e konkretisht procesverbali datë 27.07.2016 i Asamblesë së Ortakëve i mungojnë tërësisht elementet e formës: mungon emri i kryetarit dhe i mbajtësit të procesverbalit, rezultati i votimit, mungon lista e pjesëmarrësve, akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme, procesverbali i mbledhjes nuk është nënshkruar nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit konform përcaktimeve ligjore dhe rregullave statutore. Detyrimi për depozitimin e procesverbalit të asamblesë në QKB përcaktohet edhe nga neni 1, paragrafi 5 i ligjit 9901/2008, i cili parashikon: “Dispozitat, që kërkojnë dhënie informacioni në faqen e shoqërisë në internet, mund të zbatohen nëpërmjet krijimit të një lidhjeje informatike të drejtpërdrejtë me faqen në internet, ku Qendra Kombëtare e Regjistrimit publikon informacionin për tregtarin apo shoqërinë përkatëse”. Në këtë formë, detyrimi që përcakton neni 90 i ligjit 9901/2008 lidhur me publikimin nga administratori i*

shoqërisë të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë është drejtpërdrejt i lidhur me publikimin e procesverbalit në QKB, veprim i cili (publikimi) në rastin konkret është kryer nga QKB duke depozituar në Regjistrin Tregtar dokumentin e paraqitur nga Gjovana Sokolaj, "Procesverbalin e Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme të Scholz Sh.p.k." datë 27.06.2016. Edhe për këtë arsye, QKB detyrimisht duhej të verifikonte elementët formalë të këtij procesverbali, për të konstatuar lehtësisht se dokumenti shoqëruar nuk plotëson kërkesat formale të nenit 27 të ligjit 9723/2007. Në deduksion të këtij arsyetimi, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga personi i tretë, nuk plotëson kërkesat formale të përcaktuara në ligj dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për regjistrim. Sa më sipër, shkresa nr. prot. 7253/1, datë 22.09.2016 e palës së paditur Qendra Kombëtare e Biznesit si dhe regjistrimi i aplikimit i kryer nga personi i tretë Gjovana Sokolaj në çështjen nr. CN-885652-08-2016 vijonë në kundërshtim me ligjin dhe si të tilla duhen shfuqizuar sipas përcaktimeve të nenit 40, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 49/2012, duke zgjidhur edhe pasojën juridike të pavlefshmërisë së regjistrimit: kthimin e gjendjes së regjistrimit në gjendjen e mëparshme.

11. Gjykata Administrative e Apelit përfundimisht vlerëson se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 308, datë 06.02.2017 duhet ndryshuar duke u pranuar padia si e bazuar në prova dhe në ligj, bazuar në nenin 53 shkronja "b" të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar. Shpenzimet gjyqësore referuar përcaktimeve të nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile i ngarkohen palës paditëse.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 53, shkronja "b" të ligjit nr. 49/2012 *Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*, i ndryshuar

VENDOSI:

Ndryshimin e vendimit nr. 308 (80-2017-310), datë 06.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në këtë mënyrë:

- Pranimin e padisë.
- Shfuqizimin e aktit të QKB-së nr. 7253/1 Prot, datë 22.09.2016.
- Shfuqizimin e regjistrimit të aplikimit të kryer nga personi i tretë Gjovana Sokolaj në çështjen nr. CN-885652-08-2016.
- Kthimin e gjendjes së regjistrimit në gjendjen e mëparshme.
- Ky vendim është i ekzekutueshëm nga shërbimi përbarimor gjyqësor.
- Shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim palës paditëse.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.


Tiranë, më 15.04.2021

ANËTARE




Blerona HASA

ANËTAR



Ardian DMORANI

KRYESUESE



Altina NASUFI

VËRTETOHEJ NJËSIA
ME ORIGINALIN
KRYESEKRETARE
ADELA DUMA